



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 11 nëntor 2015  
Nr. ref.:RK848/15

## VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

**Rastin nr. KI28/15**

Parashtrues

**Naser Dragusha dhe 4 punëtorë të tjera të Korporatës Energjetike të Kosovës**

**Kërkesë për rivlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013**

## **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe  
Bekim Sejdiu, gjyqtar

### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë: z. Naser Dragusha, z. Bajram Ahmeti, z. Mehmet Shaqiri, z. Shasivar Hashani dhe znj. Selvete Preniqi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit), të përfaqësuar nga z. Ilaz Çerkinaj, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin, Rev. 25/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 10 majit 2013, i cili atyre u është dorëzuar më 10 korrik 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është kërkesa për rivlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, Rev. nr. 25/2012 të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesve të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushteuuese**

5. Më 10 mars 2015, parashtruesit dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 21 prill 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI28/15 caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI28/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.
7. Më 6 maj 2015, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga të njëjtët plotësimin e formularit të kërkesës, duke ia bashkëngjitur kërkesës vendimin e fundit të cilin e kontestojnë, si dhe dokumentet të tjera relevante.
8. Më 21 maj 2015, parashtruesit dorëzuan dokumentacionin shtesë të kérkuar nga Gjykata.
9. Më 11 shtator 2015, pas shqyrtimit të rapportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi njëzëri Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përbledhja e fakteve**

10. Përkitazi me pretendimet e njëjta, të ngritura nga parashtruesit, Gjykata tashmë ka vendosur në Rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014 dhe në Rastin KI165/14, të 9 korrikut 2015.

**Përbledhja e fakteve përkitazi me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014**

11. Më 18 tetor 2013, parashtruesit e kërkesës z. Naser Dragusha, Mehmet Shaqiri, z. Bajram Ahmeti, z. Shasivar Hashani, z. Qazim Igrishta, z. Fahri Asllani dhe znj. Selvete Preniqi dorëzuan kërkesën në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 25/2012, të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013.
12. Parashtruesit, në Rastin KI163/13, pretendonin se u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtimit të Profesionit] dhe me nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
13. Gjykata në Rastin KI163/13 vlerësoi se Gjykata Supreme, përkitazi me pretendimet e parashtruesve, qartë e ka shpjeguar raportin ndërmjet parashtruesve si punëtorë dhe KEK-ut si punëdhënës, bazuar në kontratën e themeluar me pëlqimin e dy palëve, si dhe të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kontrata e tillë; dhe për më tepër, Gjykata Supreme po ashtu ka dhënë vlerësim të qartë të vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët.
14. Përveç kësaj, Gjykata vlerësoi se fakti që parashtruesit nuk pajtohen me rezultatin e rastit nuk mund të ngrenë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtimit të Profesionit] të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazuki Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
15. Rrjedhimisht, Gjykata nuk gjeti shkelje të të drejtave të parashtruesve, të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013.
16. Në bazë të fakteve dhe rrethanave që janë paraqitur në kërkesën nr. KI163/13, Gjykata më 23 qershor 2014 përfundoi se kërkesa e parashtruesve ishte deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar.

**Përbledhja e fakteve përkitazi me Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në Rastin KI165/14, të 9 korrikut 2015**

17. Më 10 nëntor 2014, parashtruesi Bajram Ahmeti dorëzoi kërkesën në Gjykatë, e cila u regjistrua me nr. KI165/14. Nëpërmjet kësaj kërkesë parashtruesi kontestoi Aktgjykimin e njëjtë të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 25/2012, të 10 majit 2013), të cilin i njëjti e kontestoi në Rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014.
18. Parashtruesi në kërkesën KI165/14 pretendoi se me Aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtimit të Profesionit] dhe nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

19. Duke pasur parasysh të gjitha faktet e shtjelluara, në Rastin KI165/14, Gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e parashtruesit për objekt të shqyrtimit kishte të njëtin aktgjykim për kushtetushmérinë e të cilit kishte vendosur në Rastin KI163/14, më 23 qershor 2014. Andaj, kërkesa e parashtruesit u deklarua e papranueshme në bazë të rregullit 36 (3) d) të Rregullores së punës.

### Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Në kërkesën e tanishme KI28/15, parashtruesit pretendojnë se me Aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

### Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata, para se ta shqyrtojë një kërkesë, së pari vlerëson nëse ajo i ka përbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Përkitazi me këtë kërkesë, Gjykata i referohet rregullit 32 (5) të Rregullores së punës, që përcakton:

*“Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër, në qoftë se kërkesa është [...] përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze”.*

23. Gjykata vëren se parashtruesit, në rastin konkret, në fakt kërkojnë rivlerësimin e Aktgjykit Rev. nr. 25/2012 të Gjykatës Supreme, të 10 majit 2013, kushtetushmérinë e të cilit Gjykata Kushtetuese e kishte vlerësuar në rastin KI163/13, të 23 qershorit 2014, dhe në Rastin KI165/14 të 9 korrikut 2015, ku parashtrues ishte z. Bajram Ahmeti njëri nga parashtruesit e Rastit KI163/13 dhe të rastit të tanishëm KI28/15. Kërkesa e tanishme, në fakt, nuk përban asnjë provë të re, në bazë të së cilës do të trajtohej një çështje e cila nuk është trajtuar, ose është anashkaluar të trajtohet në procedurat e mëhershme në Gjykatë.
24. Prandaj, kërkesa e tanishme është përsëritje e kërkeseve të mëparshme të vendosura nga Gjykata. Gjykata nuk ka juridikSION të vendosë për çështjet e njëjtë juridike për të cilat një herë ka vendosur. JuridikSIONI i Gjykatës Kushtetuese, përkitazi me kërkeshat individuale, është përcaktuar qartë me nenin 113.7 të Kushtetutës. Me akte individuale të autoriteteve publike në kuptim të nenit 113.7, duhet nënkuPTUAR të gjitha aktet individuale të autoriteteve publike të Republikës së Kosovës, që paraqesin objekt të vlerësimit të kushtetutshmërisë sipas kuptimit të këtij neni, përvëç atyre të vetë Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, duhet kuptuar qartë dhe drejtë se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridikSION t'i rihapë dhe t'i rigjykojë vendimet e saj për të cilat ka vendosur.

25. Për më tepër, Gjykata rikujton se vendimet e saj janë vendime të formës së prerë dhe të detyrueshme për gjyqësorin, për të gjithë personat dhe për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës.
26. Përkitazi me këtë, nen 116.1 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës, përcakton: “*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës*”.
27. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesve, në fakt, është përsëritje e kërkesave të mëparshme të vendosura nga Gjykata. Prandaj, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores, kërkesa duhet të refuzohet.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me rregullin 32 (5) të Rregullores së punës, më 30 tetor 2015, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari rapportues**



Bekim Sejdiu

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi

